



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses – praktikante Alma Osmani Sejdiu, në çështjen penale kundër të pandehurve E. D. dhe K. D. që të dy nga Vushtrria, rr. ”B. S.”, për shkak të veprës penale “Sulm” nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.65/16 te dt.04.01.2017, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 22.11.2021, në të njëjtën datë shpalli, ndërsa me datë 26.11.2021 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

NDAJ TË PANDEHURIT TË PARË: E. D. nga babai B. dhe e ëma S. e gjinisë B. i lindur me në fshatin D. e P.- Vushtrri, tani jeton në Vushtrri, rr. ”B. S.”, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i katër fëmijëve, me numër personal ... i gjendjes së mesme ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në pajtim me dispozitat e nenit 363 paragrafi 1 pika 1.1 të KPP-së:

REFUZOHET AKUZA

SEPSE: me datë 08.12.2015 rreth orës 18:00 në Vushtrri, të pandehurit kanë sulmuar të dëmtuarën A. S. në atë mënyrë që të pandehurit kishin shkuar në shkollë fillore për ta marrë vajzën e tyre E. D. e cila kur është takuar me prindiu kishte thënë se A.S. e kishte rrahur në oborr të shkollës, të pandehurit kanë hyrë në automjet dhe kanë vazhduar për në shtëpi, po sa kanë arritur në rrugën A. G., kanë parë A., kanë ndaluar automjetin dhe kanë sulmuar të dëmtuarën duke e goditur me grushta dhe shkelma nëpër pjesë të ndryshme të trupit.

- **Me këtë kishte për të kryer veprën penale “Sulm” nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, kurse**

E PANDEHURA E DYTË: K.D. nga babai B. dhe e ëma Z. e gjinisë Z. e lindur më ... në Vushtrri, ku edhe tani jeton, në rr. ”B. S.”, me nr. personal ... amvise, e martuar, nënë e katër fëmijëve, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE: me datë 08.12.2015 rreth orës 18:00 në Vushtrri, e pandehura ka sulmuar të dëmtuarën A. S. në atë mënyrë që të pandehurit kishin shkuar në shkollë fillore për ta marrë vajzën e tyre E. D. e cila kur është takuar me prindiu kishte thënë se A. S. e kishte rrahur në oborr të shkollës, të pandehurit kanë hyrë në automjet dhe kanë vazhduar për në shtëpi, po sa kanë arritur në rrugën A. G. kanë parë A. kanë ndaluar automjetin dhe e pandehura K. e ka sulmuar të dëmtuarën duke e goditur me grushta dhe shkelma nëpër pjesë të ndryshme të trupit.

- **Me këtë ka kryer veprën penale “Sulm” nga neni 184 par.1 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17, 38, 40, 42, 69, 70 dhe nenit 184 par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365, 450, 463, të KPP-së të pandehurës së dytë i shqipton:

DËNIM ME BURGIM

Te pandehurës së dytë **K. D.** gjykata i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajsh**, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar A. S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

DETYROHET e pandehura e dytë që ne emër te shpenzimeve procedurale te paguajë: ne emër te paushallit gjyqësor shumen prej **30€ (tridhjetë euro)** në emër te shpenzimeve për ekspertizë mjekoligjore shumën prej **20€ (njëzetë euro)**, si dhe ne emër te Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimin shumën prej **30€ (tridhjetë euro)**.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.65/16 te dt.04.01.2017 kundër të pandehurve E. D. dhe K. D. për shkak të veprës penale “Sulm” nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prokurorja e shtetit Natasha Tanic në shqyrtimin gjyqësor të datës 22.11.2021 ka bërë rikualifikimin e veprës penale duke u bazuar në nenin 3 par.2 të KPRK-së (Kodit nr. 06/L-074) ku thuhet se “*Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm*”, e pasi që kjo vepër penale me Kodin e ri Penal është më e favorshme për të pandehurin, nga neni 187 par.1 ka bërë rikualifikimin në nenin 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ndaj të pandehurve E. D. dhe K. D. ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 02.10.2019, ku në këtë seancë gjyqtari i vetëm gjykues i ka njoftuar të pandehurit me të drejtat e tyre në këtë çështje penale. Pas kësaj, gjykata e ka ftuar prokurorin e shtetit që t’ua lexojë aktakuzën të pandehurve.

Pas leximit te aktakuzës nga ana e prokurorit te shtetit, dhe pasi qe gjykata është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, të pandehurve u është dhënë mundësia që të deklarohen lidhur me fajësinë.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i pandehuri E. D. **nuk e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës.**

Ndërsa, e pandehura K. D. **e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës.** Pas pranimit të fajësisë, gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të pandehurës lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë dhe të njëjtën e ka njoftuar me favorret dhe disfavorret e pranimit te fajësisë dhe me dënimet e parapara me nenin 184 par.1 të KPRK-së, por qe e pandehura edhe pas këtyre paralajmërimeve ka deklaruar se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës.

Gjykata pranimin e fajësisë nga e pandehura e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 248 par 1 të KPPK-së dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës.

Andaj, gjykata e ka pranuar deklarimin mbi pranimin e fajësisë nga e pandehura sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale te cilat gjinden ne shkresat e lendes dhe atë: raporti i oficerit i dt.08.12.2015 me nr. te rastit 2015-BD-1168, raporti policor i dt. 08.12.2015, procesverbali i marrjes ne pyetje të të dyshuarit E. D. i dhënë ne polici, i dt. 08.12.2015, procesverbali i marrjes ne pyetje të të dyshuarës K. D. i dt. 08.12.2015, procesverbali i marrjes ne pyetje të të dëmtuarës A.S. i dt. 08.12.2015, raporti i Spitalit Sh. Z. në Vushtrri i dt. 08.12.2015, me nr. rendor 644, ekspertiza mjeko-

ligjore e dt. 04.09.2016 në emër të të dëmtuarës si dhe provat personale të administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atë vetë deklaratat e të pandehurve E. dhe K. D. si dhe deklarata e të dëmtuarës A.S. Të gjitha këto prova vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që e ka kryer e pandehura, andaj mbi këtë bazë gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin mbi pranimin e fajësisë e ka pranuar.

Gjykata ka vazhduar me procedurën dhe ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale me datë 22.11.2021 në të cilën kanë qenë prezent prokurorja e shtetit Natasha Tanic, të pandehurit E. dhe K. D. dhe e dëmtuara A. S. Gjatë procedurës së provave është marrë në pyetje dëshmitarja- e dëmtuara A. S. janë marrë në pyetje të pandehurit dhe janë administruar provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës.

E dëmtuara gjatë marrjes në pyetje ka deklaruar se me vajzën e të pandehurve E. D. kanë qenë në një klasë, e gjithë klasa kanë pasur probleme prej saj dhe në ditën kritike pasi e kanë përfunduar mësimin janë rrahur në oborr të shkollës, pastaj e dëmtuara është nisur për në shtëpi dhe rrugës duke shkuar e kanë ndalur veturën E. me familjen e saj dhe e kanë rrahur, e dëmtuara ka theksuar se më shumë e ka rrahur nëna e E.(e pandehura K.), e ka rrahur me shuplaka, ndërsa për të pandehurin E. ka theksuar se nuk i kujtohet ta ketë goditur ai, dhe se ka qenë natë e nuk e ka parë që e ka goditur. E dëmtuara ka deklaruar se në ato momente kur ka ndodhur sulmi i ka rënë të fikët dhe pastaj disa djem që kanë qenë afër shkollës e kanë ndihmuar dhe pasi që shtëpia e saj ka qenë afër vendit të ngjarjes i kanë lajmëruar familjarët e saj.

I pandehuri E.D. gjatë marrjes së tij në pyetje ka deklaruar se në ditën kritike në rrugën A. G. e ka ndalur veturën, sepse e pandehura K. ka dashur ta pyesë të dëmtuarën pse ia ka rrahur vajzën. Sipas të pandehurit, fillimisht vetëm bashkëshortja e tij ka dalur nga vetura dhe ka thënë se e dëmtuara e ka pështyer të pandehurën, pastaj e pandehura ia ka dhënë një shuplakë, e pas kësaj ka dalë edhe i pandehuri nga vetura dhe e ka marrë të shoqen e tij e ka futur në veturë.

E pandehura K. D. edhe gjatë deklarimeve të saj në shqyrtim gjyqësor sërish ka pohuar se e ka goditur të dëmtuarën, sepse sipas saj e njëjta e ka pështyer, e pandehura është mërzhitur shumë kur e ka parë vajzën e saj me lëndime në sy dhe për këtë arsye e ka sulmuar të dëmtuarën. Mes deklarimeve të saj e pandehura nuk ka shprehur fare keqardhje për veprën e kryer, përkundrazi ka theksuar se është penduar pse nuk e ka rrahur edhe më shumë të dëmtuarën, e ka fyer atë vazhdimisht dhe ka theksuar se kurrë nuk ia fali asaj se e ka goditur vajzën e saj dhe është sjellë keq me të. Gjatë kohës derisa e pandehura ka dhënë këto deklarime si më sipër, e dëmtuara sërish ka shpërthyer në vaj dhe pa mëdyshje është vërejtur se e njëjta ende frikësohet nga prezenca e të pandehurës.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare dhe lidhur me pranimin e fajësisë se te pandehurës ka deklaruar se së pari heq dorë nga ndjekja penale kundër të pandehurit të parë E. D. për veprën penale për të cilën me aktakuzë i vihet në barrë, kjo për arsyet vijuese: pas dëgjimit të të dëmtuarës-dëshmitares A. S. se me datë 05.12.2015 pas kthimit nga shkolla ka qenë e sulmuar vetëm nga nëna e E. dmth K.D. dhe nga kjo vie në përfundim se nuk ka elemente të veprës penale se i pandehuri E. D.ka kryer veprën penale si ne aktakuzë. Sa i përket të pandehurës së dytë K. D. e njëjta ka pranuar fajësinë dhe gjykatës i ka propozuar qe ta pranojë pranimin e fajësisë, e me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata duhet ta ketë parasysh një fakt qenësor se edhe E. D. si bashkëshort i të pandehurës ka theksuar dhe ka dëshmuar se është e vërtetë se K. D. në ditën kritike e ka goditur atëherë të miturën A. S. e cila atëherë ka pasur vetëm 13 vite, e qe gjykata si rrethanë rënduese të ketë parasysh faktin dhe mënyrën e sjelljes së të pandehurës në sallën gjyqësore, që në asnjë rast nuk ka shprehur pendesë për atë që ka bërë, por që ka deklaruar se në ato momente ka qenë aq e zemëruar aq sa do të donte që edhe më shumë ta godiste, e qe konsideroj se janë rrethana rënduese që veçanërisht duhet të merren parasysh me rastin e shqiptimit të dënimit dhe nga këto arsye gjykatës i ka propozuar që ta shpallë fajtores dhe ta dënojë sipas ligjit.

Ndërsa, sa i përket të pandehurit E. D. gjykata mori aktgjykim refuzues duke u bazuar në dispozitat e nenit 363 paragrafi 1 pika 1.1 të KPP-së, pasi që prokurorja e shtetit u tërhoq nga ndjekja penale sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor u provua se veprën penale si në aktakuzë e ka kryer vetëm e pandehura K. D. e kjo bazuar në deklarinimet e vetë të pandehurve dhe deklaratën e të dëmtuarës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 41, 73 dhe 74 të KPRK-së, si dhe në Udhëzuesin për Politikën Ndëshkimore të datës 15.02.2018, ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethanë lehtësuese për të pandehurën vlerësoi pranimin e fajësisë, ndërsa rrethana të tjera lehtësuese nuk gjeti.

Si rrethana rënduese gjykata mori parasysh peshën e veprës penale të kryer nga e pandehura dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës së kryer, faktin se vepra penale është kryer ndaj një viktime të ndjeshme- një fëmije të mitur, fakti se ka kaluar një kohë e gjatë përkatësisht 6 vite që nga kryerja e veprës penale, e përkundër kësaj e pandehura aspak nuk ka shprehur pendesë për veprën e kryer, nuk ka shprehur keqardhje, gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor e ka fyer të dëmtuarën dhe ishte e mbushur me mllef për shkak të një zënke që ka ndodhur mes fëmijëve. Mes tjerash, e pandehura ka deklaruar se “më vjen keq që nuk e kam bo llom” gjë që dëshmon për shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e kësaj vepre penale. Si rrethana rënduese gjykata vlerësoi edhe prezencën e dhunës në kryerjen e veprës penale si dhe shkallën e lartë të pjesëmarrjes së të pandehurës në kryerjen e veprës penale.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Së këndejmi me pranimin e gjitha këtyre rrethanave, nuk ka pasur vend që të pandehurës t'i shqiptohet dënim më i rëndë apo më i butë.

Andaj, gjykata vlerësoi se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurës do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryerësen nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin në rastin konkret, që e pandehura në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 nën par.2.1 dhe 2.6 të KPP-së.

Vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par.2 të KPP-së.

Nga të lartë cekurat e bazuar në nenin 365 të KPPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.1/17, datë: 26.11.2021

**Procesmbajtëse
Alma Osmani Sejdiu**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi. Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.